

Rrok Gjollaj ● Ermira Alija

BUKURIA E LEXIMIT

LETËRSIA 2
Për klasën e dytë të shkollës fillore
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2020

Rrok Gjolaj Ermira Alija

BUKURIA E LEXIMIT

LETËRSIA 2

PËR KLASËN E DYTË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

LJEPOTA ÇITANJA

KNJIŽEVNOST 2

PRIRUČNIK ZA DRUGI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Pavle Goranoviq

Kryeredaktor: Radulle Novoviq

Redaktor përgjegjës: Llazo Lekoviq

Redaktor i librit: Dimitrov Popoviq

Recensues: Prof. dr. Mark Camaj
Prof. dr. Fatbardha Hoxha
Islam Dreshaj
Prof. as. dr. Fatmir Vadahej
Prof. dr. Vehbi Hoti

Dizajni dhe faqosja: studio Zuns

Lektor: Mr. Marjan Lulgjuraj

Korrektor: Dimitrov Popoviq

Redaktore teknike: Dajana Vukçeviq

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2381-2
COBISS.CG-ID 17035012

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 10903-119/20-3335/10 të datës 24. 07. 2020 e ka miratuar këtë komplet të Tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
ECURIA METODIKE	6
ZËRI I SHKOLLËS	7
Naim Frashëri: GJUHA JONË	8
Rita Petro: SHTATORI	9
Adelina Mamaqi: DORË MOJ, E VOGËL DORË	10
Agim Deva: NËNËS	11
PËRRALLA NË VESH, E MIRA PREJ NESH	12
Luigj Gurakuqi: MENDONI PËR TË TJERËT	13
Tregim popullor: TRE MJEKËT E MËDHENJ	14
Fabul popullore: LUANI E MIU	15
Fabul popullore: TRE DERRKUCËT	16
Odhise Grillo: KUR BIE SHI	17
QETËSI	18
Xhevahir Spahiu: SHQIPONJA	19
Dushan Gjurishiq: DHJETORI	20
Kristina Nystlinger: DY SHOQET	21
Adelina Mamaqi QETËSI	22
PËRRALLA E KLASËS	23
GËZIMET TONA	24
Janaq Pani: GËZUAR DITËLINDJEN	25
Vehbi Kikaj: TRI GËZIME	26
Sami Frashëri: MOS E FSHIH FAJIN	27
David Feil: EMA LEXON LIBRIN	28
EJANI DORË PËR DORË	29
Naum Prifti: GURI I SKËNDERBEUT	30
Rifat Kukaj: MYSAFIRËT	31
Nol Berisha: SI U MËSUA FRANI TË LEXOJË	32
Xhevahir Spahiu: LIBRAT RRINË RADHË-RADHË	33
LIBRI IM, LIBRAT E MI	34
LOJËRA, PËRRALLA, TREGIME	35
Leximet jashtë klase: XIXËLLONJA E VOGËL DHE PINOKU	36

PARATHËNIE

Të nderuar kolegë

Ky që keni në dorë, është Manuali i mësuesit, që është pjesë e kompletit të tekstit mësimor “Leximi letrar për klasën e dytë të shkollës fillore”, që përfshin edhe librin e nxënësit dhe fletoren e leximeve jashtë klase.

Ky libër lindi si propozim për disa forma të qasjes ndaj tekstit dhe nxënësve, duke mbajtur parasysh disa udhëzime të rëndësishme të programit, si: estetikën e receptimit, strategjitë e leximit, etapat e punës me tekstin letrar, metodën e mbartjes graduale të përgjegjësisë, ngjeshjen e tekstit, konjitivizmin dhe metakonjitivizmin e të tjera, si dhe rezultatet edukativo-arsimore e arritjet e dëshiruara. Por ju e dini të nderuar kolegë që janë planifikuar 18 tema për leximin e klasës së dytë dhe janë propozuar 20 tituj. Ju e dini gjithashtu që këto tema do të shtrihen gjatë gjithë vitit mësimor, që do të thotë se çdo temë është më shumë se një orë, ndoshta edhe më shumë se një javë. Kjo është arsyeja se pse propozimet tona për një temë janë më të fryra se për një orë të zakonshme mësimi. Janë menduar kështu, që të përmbajnë propozime për më shumë se një orë duke u përpjekur njëkohësisht të mos zëvendësojnë planifikimin ditor të mësuesit, i cili varet nga shumë faktorë dhe s’mund të jetë standard.

Ka shumë aktivitete që mund të integrohen në mësimdhënien tuaj, të nderuar kolegë, duke filluar me lojra të ndryshme (qofshin ato edhe gjuhësore), konkurse, vizita në muze dhe ekspozita, shikime filmash (vizatimorë a artistikë), apo emisionesh të tjera për fëmijë. Të gjitha këto janë në dorën tuaj, sepse askush më mirë se ju, nuk mund ta dijë se kur dhe çfarë duhet bërë.

Ne mendojmë se ky manual mbetet një sugjerues i mirë, pasi mbart në vete shumë eksperiencë dhe shumë punë. Megjithatë do të donim të theksonim disa parime, që kanë qenë në bazë të punës sonë, por që mendojmë se janë të rëndësishme edhe për ju kolegë, si bashkarkitektë dhe bashkorganizatorë të orës së mësimi:

- Më shumë vëmendje aktiviteteve receptive të nxënësve, sesa produktive, pasi nuk janë ende të pavarur.

- Nuk duhen detyruar fëmijët të lexojnë pa dëshirë; leximi nuk duhet përjetuar si mundim.

- Dashuria për letërsinë kultivohet, nuk programohet.

Këto parime nuk ftojnë nxënësit për të mos lexuar, por ftojnë mësuesit për të gjetur mënyra që t’i bëjnë nxënësit ta duan të lexuarit.

Na mbetet të shpresojmë që ky manual të bëhet një mik i mirë për ju, ashtu si janë miqtë e vërtetë, që nuk të zënë vendin, por edhe që dinë të të frymëzojnë me qenien e tyre.

Autorët

ECURIA METODIKE PËR REALIZIMIN E SYNIMEVE

ZËRI I SHKOLLËS

Duke u mbështetur mbi metodën e mbartjes graduale të përgjegjësisë, mësimet hyrëse janë konceptuar pa objektiva nga ne. Kemi menduar që këtë gjë t'ia lëmë në dorë mësuesit, me qëllim që të mos e ngusim, por të stimulojmë nisjen e tij nga gjendja e klasës dhe aktivizimin gradual të saj deri në maksimizim të interesit.

Mësuesi vetë mund të vendosë objektiva që mund të lidhen me: edukimin e të dëgjuarit, me zhvillimin e të shprehurit lirshëm për situata të ndryshme që kanë përjetuar fëmijët në klasën e parë, me shprehjen e emocioneve dhe ndjenjave që mbajnë mend nga shkolla apo pushimet.

Pavarësisht se libri ka disa figura, ne u propozojmë mësuesve që të ndjehen të lirë të shtojnë aktivitete të tjera, si p.sh.: të sjellin disa fotografi të bëra me nxënësit në vitin e parë të shkollës, ose të inkurajojnë nxënësit të sjellin të tilla, apo të bëra gjatë pushimeve verore.

Kjo me qëllim që të shtohet mundësia receptive e nxënësve dhe të mos ndjehen të sforcuar të rrinë brenda një strukture që mund t'i ngushtojë.

Lidhja me tekstet e klasës së parë është bërë me qëllim që nxënësi ta konceptojë shkollën si vijimësi. Kështu mësimi i jep atij edhe një feed-back për shkollën, si vend i dashur, i njohur, që ka vazhdimin e vet të natyrshme, pavarësisht se është një klasë më lart dhe që ta shohin përvojën e kaluar me sportivitet dhe nga një lloj largësie.

Gjatë këtyre orëve mësuesi mund të llogaritë të përdorë një fjalor të pasur, deri diku të programuar, sipas secilës fushë leksikore me të cilën do t'u drejtohet nxënësve dhe t'i nxitë ata t'i përdorin ato fjalë, nëpërmjet dhënies së përgjigjeve.

Mban shënime për reagimet e nxënësve duke u munduar të kuptojë veçantitë e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es

Naim Frashëri

GJUHA JONË

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe për ta lidhur me ndonjë përjetim nga jeta reale.

Arritjet

- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë dhe fjalët që rimojnë
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe arsyet pse
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar

Mësuesi shkruan titullin dhe i fton nxënësit të flasin për gjuhën: Çfarë është gjuha? Çfarë është gjuha e nënës? Ç'do të thotë gjuhë e ëmbël? A ka dalë prej këtej fjala gojëmbël...?

I fton nxënësit të dëgjojnë vjershën.

I fton të shkruajnë cilësimet që i bëhen gjuhës.

Fton nxënësit të tjerë për të diskutuar se si i kuptojnë këto cilësime: Ç'do të thotë *gjuhë e ëmbël, e dliërë, e mirë, e vlerë, e lehtë, e bukur*?

Këto cilësime janë vetëm për gjuhën shqipe apo çdo njeri i thotë për gjuhën e nënës? Atëherë, pse vjersha titullohet "Gjuha jonë"?

Ftohen nxënësit ta lexojnë vetë vjershën dhe ta thonë përmendësh. Vlerësohen ata që mund ta thonë.

Ftohen të plotësojnë librin.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Rita Petro

SHTATORI

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar, të dallojë pjesët e vjershës
- të lidhë përmbajtjen e tekstit të dëgjuar dhe të lexuar me ndonjë përjetim nga jeta reale.

Arritjet

- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me situatën e përshkruar

Mësuesi tregon titullin e poezisë: *Shtatori*

I fton nxënësit të tregojnë se çfarë u kujton kjo fjalë. I nxit që të tregojnë sa më shumë dhe shënon në tabelë fjalë kyçe që lidhen me poezinë.

Lexon poezinë.

I nxit nxënësit që të thonë me fjalët e tyre përmbajtjen e çdo vargu.

I nxit nxënësit të vërejnë se kush e ka shkruar poezinë.

I nxit të vërejnë se kush e tregon ngjarjen.

I fton të vërejnë se cili është personazhi kryesor i saj. Çfarë bën, çfarë mban, çfarë ndien?

I fton të vënë re se si është e ndërtuar ajo (me vargje, jo rreshta). I fton të vërejnë si grupohen vargjet (në strofa 4-she). I fton të përgjigjen se pse bëhet kjo?

Rilexon poezinë bukur.

I fton edhe nxënësit ta rilexojnë bukur me zë të ulët, ta shijojnë individualisht.

I fton të punojnë në libër pyetjet dhe përgjigjet, duke u thelluar në detaje të përmbajtjes sipas perceptimeve dhe asociacioneve individuale.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Adelina Mamaqi

DORË, MOJ, E VOGËL DORË

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të dallojë pjesët e vjershës
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti dhe arsyet pse.

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë dhe fjalët që rimojnë
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe arsyet pse
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar

Mësuesi shkruan titullin në tabelë dhe i fton nxënësit të flasin për gjymtyrët e njeriut: Cilat janë? A janë të rëndësishme? A ka thënë ndokush me vete ndonjëherë: “O ... këmbët e mia ... sa jeni lodhur, oh ... dora ime...”?

I fton të ndjekin leximin e poezisë.

Vazhdon diskutimin: Po autori i poezisë çfarë ka shkruar për duart? Ndaj çdo përgjigjeje të nxënësve, mësuesi pyet edhe për mendimin e tyre, i fton edhe ata të tregojnë për veten dhe të japin mendimin e tyre.

Kur mbarojnë vargjet, i pyet për mendimin e përgjithshëm të poezisë (sintetizimin e mendimit).

Pastaj i pyet nëse u pëlqen poezia dhe arsyet pse. Inkurajon nxënësit që të japin përgjigje personale dhe të argumentuara.

Pastaj i fton ta shijojnë edhe një herë poezinë si bukurtingullim.

E lexon bukur.

I fton nxënësit të flasin se çfarë e bën të bukur poezinë si tingullim. I fton të vërejnë strofat, fjalët që rimojnë, ritmin që është si lojë.

I udhëheq të punojnë në libër.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Agim Deva

NËNËS

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të shprehë përmbajtjen e tekstit dhe ta lidhë me ndonjë përjetim të vet nga jeta reale
- të dallojë pjesët e vjershës
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo poezia dhe të tregojë arsyet se pse

Arritjet

- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Krahason sjelljen e personazheve të tekstit me sjelljen e vet, duke treguar se çfarë i pëlqen dhe pse.

Tregohet nga mësuesi titulli i poezisë "NËNËS"

Përgatitet horizonti i pritjes i nxënësve me pyetjen "Çfarë është nëna?" duke u përpjekur të mbledhë nga fëmijët shumësinë e të vërtetave që krijojnë konceptin e nënës: nëna e mban në bark fëmijën, e ndien kur lëviz, e lind, e ushqen, e mëson të ecë, e shoqëron ...

I fton nxënësit të ndjekin një shfaqje ndryshe të ndjenjave për nënën në poezi. Lexon poezinë.

Fton nxënësit të vërejnë se cili është autori, cilat janë personazhet, kush tregon në poezi dhe çfarë tregon.

I fton të vërejnë organizimin e vargjeve, llojin e strofës. I fton të vërejnë efektin.

I fton të ndiejnë bukurinë e poezisë dhe e lexon edhe një herë bukur.

I fton ta lexojnë vetë poezinë, ta shijojnë dhe kuptojnë.

Pastaj i drejton tek plotësimi i librit për t'u thelluar në përmbajtjen dhe perceptimin individual të saj, së bashku me pëlqyeshmëritë.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

PËRRALLA NË VESH, E MIRA PREJ NESH

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dallojë llojet e teksteve në kapitullin e ri, sipas përshkrimeve që i shoqërojnë
- të dallojë titullin, shkrimtarin
- të dallojë ndryshimet në formë të pjesëve: gjatësi, varg/rresht, strofë
- të intutojë llojin nëpërmjet titullit

Arritjet

- Tregon shkrimtarin dhe titullin e secilës pjesë
- Lexon dhe i bën pjesë diskutimi termat: fabul popullore, tregim popullor
- Thotë me fjalë sa poezi dhe proza ka kapitulli
- Tregon tituj të tjerë përrallash, vjershash dhe bën krahasime

Orët që përgatitin hyrjen në kapitullin e dytë, ne kemi menduar t'i përdorim për të nxitur kureshtjen e nxënësve për leximet që do të vijnë, si dhe për të bërë një shikim krahasues e sintetik të llojeve të leximeve që janë aty, gjë që nuk mund ta bëjnë me një lexim të vetëm.

Prezantimi i mësuesit mund të fillojë me titullin që i kemi vënë kapitullit "PËRRALLA NË VESH, E MIRA PREJ NESH". Nxënësit mund të pyeten se çfarë u kujtojnë këto fjalë. Pastaj ata ftohen të shohin tekstet që janë nën këtë rubrikë. Ftohen të lexojnë titujt. Ata mund të shkruhen në tabelë. Mësuesi insiston në përdorimin e termit titull dhe përpiket që ta bëjë atë edhe objekt të fjalës së nxënësve (duke i porositur që të përgjigjen me fjali të plota): Cili ishte titulli i parë? Po titulli i dytë? Titulli i tretë? ... Mësuesi vazhdon të pyesë për shkrimtarin. A ka ndonjë emër shkrimtari që shënohet tek pjesa parë, e dytë ... Pastaj i fton të vërejnë se sa të gjata janë pjesët dhe si janë të shkruara. Sa prej tyre ngjajnë si formë, sa janë ndryshe? Fton 5 nxënës të dalin para shokëve dhe të paraqesin 5 tekstet e ndryshme. I fton nxënësit të shohin dhe t'i artikulojnë me fjalë të përbashkëta e të veçanta të teksteve, të prozës e poezisë.

Përpiket që diskutimin ta lërë në planin e formës, për të mos shuar kuriozitetin e teksteve që do të bëhen më vonë. Gjatë pyetjeve ai përdor fjalët: shkrimtar, titull, poet, tekst, poezi, vjershë, prozë, përrallë, fabul, tregim etj.

Mund të ndërtojë bashkë me nxënësit skema konceptuale në varësi të asaj që i duket me interes për nivelin e klasës me teknika të ndryshme didaktike.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Luigj Gurakuqi

MENDONI PËR TË TJERËT

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e të lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të dallojë pjesët e tregimit
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti, ndonjë pjesë e tij dhe arsytet pse

Arritjet

- Dallon fillimin, zhvillimin dhe fundin e tregimit
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Ndryshon përmbajtjen e tekstit
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe arsytet pse

Mësuesi mund ta fillojë mësimin duke pyetur nxënësit nëse u duket normale që “Të mendojnë për të tjerët” dhe ndërkohë shkruan titullin në tabelë.

Nxënësit lihen të lirë të thonë mendimet e tyre. Mësuesi u ruhet moralizimeve. I fton nxënësit të dëgjojnë pjesën.

E lexon atë.

I fton nxënësit në diskutim: Si fillon tregimi? Cili është personazhi kryesor? Si vazhdon tregimi? Si mbyllet? (Gjithnjë u kërkohet të përdorin fjali të shkurtra dhe përgjigjet t’i referohen tekstit sa më konkretisht).

Ftohen nxënësit ta lexojnë vetë pjesën dhe të jenë të vëmendshëm në personazhin e plakut dhe në qasjen e tij ndaj së mirës.

I fton të fantazojnë një tregim duke vënë në qendër të kundërtin e personazhit kryesor. Mund ta bëjnë këtë punë në grupe. Pastaj e tregojnë.

Mësuesi mund t’i pyesë se si ndryshon përmbajtja? A i pëlqen personazhi i tregimit? Po i kundërti që fantazuan? Çfarë efekti sjell ai në tregim, duke u bërë i tillë?

Ftohen nxënësit të reflektojnë në punën që bëhet në libër.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Tregim popullor

TRE MJEKËT E MËDHENJ

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti, ndonjë pjesë e tij dhe arsytet pse

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon situata nga jeta reale, që asociojnë me domethënien e ngjarjes së përshkruar
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe arsytet pse
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar

Mbasi shkruan titullin, mësuesi i fton nxënësit të tregojnë se ç'dinë për mjekët, ç'bëjnë ata dhe a kanë dëgjuar ndonjëherë prindërit të thonë për ndokënd "mjek i madh"?

I lë të diskutojnë në individualitetin e tyre e pastaj i fton të dëgjojnë tekstin.

Lexon tregimin.

I fton nxënësit në diskutim: Cili është fillimi i tregimit? Për çfarë flitet aty? Çfarë ndodh më pas? Pse habiten mjekët? Si u përgjigjet mjeku i sëmurë? Si e kuptoni fjalën e mjekut që po vdes? A mund të jetë kjo mbyllja e tregimit?

I fton nxënësit të tregojnë ndonjë shembull, duke kujtuar detaje nga jeta e tyre, që ka lidhje me atë që tha doktori në fund.

I fton ta lexojnë edhe një herë pjesën, para se të fillojnë me plotësimin e librit.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

LUANI DHE MIU

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar,
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e të lexuar
- të krahasojë thjesht llojet letrare sipas formës dhe përmbajtjes

Arritjet

- Dallon fillimin, zhvillimin dhe fundin e tregimit
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Ndryshon përmbajtjen e tekstit duke krijuar një përfundim të ri
- Krahason llojin duke pasur parasysh thjesht formën dhe përmbajtjen
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar

Mësuesi shkruan titullin në tabelë dhe i fton nxënësit të tregojnë çfarë dinë për luanin. Mund ta rrethojë fjalën me përcaktorët më të rëndësishëm që japin fëmijët.

Pastaj i pyet nxënësit për miun. Mund të shënojë përsëri përcaktorët kryesorë edhe për miun.

I fton nxënësit të fantazojnë se ç'mund t'i ndodhë luanit të madh... e miut të vogël... Duket sikur nuk mund të jenë as miq, as armiq.

Pasi i lë të fantazojnë pak, i fton të dëgjojnë pjesën. E lexon.

I fton nxënësit të tregojnë si fillon pjesa. U tërheq vëmendjen që të flasin me fjali të shkurtra.

Pastaj aktivizon nxënësit të ndryshëm të tregojnë me nga një fjali të shkurtër se çfarë ndodhi dhe si mbaroi pjesa.

Nxënësit nxiten të tregojnë me fjali të shkurtra. Mund të aktivizohet nxënësi pasardhës për të thënë të njëjtin mendim sa më ngjeshur. Fjalitë e shkurtra mund të shkruhen në tabelë (ndoshta edhe pa rregull, si dolën nga nxënësit). Arsyetohet radha e veprimeve, duke shqyrtuar fjalitë. Shënohet mbyllja. Ftohen nxënësit të interpretojnë domethënien e mbylljes.

I fton nxënësit të mendojnë një mbyllje tjetër. I fton të reflektojnë se si ndryshon mendimi që përcjell pjesa, kur ndryshon mbyllja.

I fton ta lexojnë vetë edhe një herë pjesën dhe të mendojnë, nëse ka në jetë personazhe që janë si luani dhe si miu (sipas mbylljes së librit). Po sipas mbylljes tjetër?

Ftohen pastaj nxënësit të punojnë në libër.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

TRE DERRKUCËT

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e të lexuar, ndërsa përmbajtjen e tekstit ta lidhë me ndonjë fakt nga jeta reale
- të dallojë pjesët e të tregojë se cila i pëlqen dhe arsyet se pse.

Arritjet

- Tregon personazhet dhe sjelljen e tyre
- Dallon pjesët e subjektit: fillimin, zhvillimin dhe fundin
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Ndryshon përmbajtjen e tekstit duke krijuar një përfundim tjetër
- Veçon çfarë i ka pëlqyer, çfarë nuk i ka pëlqyer dhe shpjegon arsyet pse.

Mësuesi shkruan titullin e pjesës në tabelë dhe përgatit klasën për përmbajtjen. Mund t'u tregojë me pak fjalë thelbin, që të heqë kuriozitetin e tepërt, me qëllim që nxënësit të jenë më të vëmendshëm ndaj detajeve të shprehjes gjatë leximit.

Mund t'u thotë se do të lexojnë një përrallë-fabulë që flet për tre vëllezër derrkucë, që janë rritur dhe duan të ndërtojnë shtëpitë e tyre për t'u mbrojtur. Të tre bëjnë zgjidhje të ndryshme....

Lexon përrallën-fabulë.

Mësuesi mund të zgjedhë të bëjë një lexim të ndërprerë, duke ftuar nxënësit të përmbledhin pjesët e lexuara dhe t'i shkruajë shumë shkurt në tabelë, ose mund ta lexojë të tërë pjesën dhe pastaj të kërkojë nga nxënësit të përmbledhin me hapa ngjarjen duke lexuar pjesë-pjesë përrallën e duke i përmbledhur ato (nëpërmjet intensifikimit të të lexuarit, ose duke bërë pyetje: Për çfarë flitet? Çfarë vendosën derrkucët? Çfarë bëri i pari, po i dyti, po i treti? Çfarë bëri ujku? Ku shkoi derrkuci? Po pastaj a u tërhoq ujku? Çfarë bënë dy derrkucët? Ku shkuan pastaj? Çfarë bëri ujku përsëri? Si ia punuan derrkucët?

Mësuesja lexon edhe një herë pjesën dhe i fton nxënësit ta dëgjojnë dhe të vënë re ndonjë detaj që i ka rrëshqitur, që nuk e kishin vënë re më parë, që nuk e kanë shkruar në tabelë.

I fton pas leximit të diskutojnë dhe të plotësojnë detaje të tjera të harruara. I fton të gjejnë pjesën që u pëlqen më shumë dhe të mendojnë pse.

I fton të punojnë në libër me pyetjet (është menduar të flitet edhe për ndërtimin si temë e ngjashme, plotësuese për të mos e rënduar moralizimin, për të rritur fjalorin dhe për të mos e bërë mësimin monoton)

Vërejtjet e mësuesit-it/es

KUR BIE SHI

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e të lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti, ndonjë pjesë e tij dhe arsytet pse.

Arritjet

- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Tregon detaje të përmbajtjes së poezisë
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer pjesa dhe arsytet pse

Mësuesi mund ta fillojë mësimin duke pyetur nxënësit nëse u pëlqen shiu dhe si mund ta kuptojnë nëse do të bjerë shi; ndërkohë shkruan titullin në tabelë.

Nxënësit lihen të lirë të thonë mendimet e tyre. Mësuesi u ruhet standardeve dhe nuk i stimulon. I fton nxënësit të dëgjojnë pjesën.

E lexon atë.

I fton nxënësit në diskutim: Si fillon poezia? Cilat janë personazhet kryesore? Si mendojnë? (Gjithnjë u kërkohet të përdorin fjali të shkurtra dhe për përgjigjet t'i referohen tekstit sa më konkretisht).

Ftohen nxënësit ta lexojnë vetë pjesën dhe të jenë të vëmendshëm në personazhin e gjyshe dhe të Petritit. Ftohen të gjejnë sa më shumë detaje në mënyrën se si përshkruhen?

I fton të tregojnë ndonjë opinion të gjysheve të tyre, duke u bërë pyetje të tilla, si: A ka prej gjysheve të tyre që mendojnë si gjyshja e poezisë? Po në ndonjë mënyrë të ngjashme? Mund ta bëjnë këtë punë në grupe. Pastaj e tregojnë.

Mësuesi mund t'i pyesë, nëse u pëlqen poezia?

I fton të gjejnë pjesët ku nipi tregon se e do gjyshen..., pjesën ku nipi nuk është dakord me gjyshen. Mund të pyesë, nëse janë të prerë dy personazhet. Cili më shumë? Si e shpjegojnë ata këtë? (Mësuesi përpiqet që të mos e drejtojë bisedën si përplasje brezash, por opinionesh dhe këndvështrimesh që nuk mund ta pranojnë menjëherë njëri-tjetrin, nga shkak i përvojave të ndryshme.)

Ftohen nxënësit të reflektojnë në punën që bëhet në libër.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

QETËSI

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dallojë llojet e teksteve në kapitullin e ri
- të dallojë titujt, shkrimtarët
- të dallojë ndryshimet në formë të pjesëve: vargje/rresht/dialogë

Arritjet

- Përdor dhe i bën pjesë diskutimi termat: prozë, dramë, poezi
- Thotë me fjalë disa ndryshime të poezisë, prozës dhe dramës
- Tregon zhanre dhe tituj të tjerë që ka lexuar

Edhe orët që përgatitin hyrjen në kapitullin e tretë, ne kemi menduar t'i përdorim për të nxitur kureshtjen e nxënësve për leximet që do të vijnë, si dhe për të bërë një shikim krahasues e sintetik të llojeve të leximeve që janë aty, njësoj si në hyrjen e kapitullit të dytë.

Në këtë hyrje kapitulli kemi zgjerimin e diskutimit të dallimit të prozës me poezinë, duke shtuar edhe dramën.

Gjithashtu, meqë në këtë kapitull kemi dy poezi, mund të bëhet objekt diskutimi edhe ndryshimi dhe të përbashkëtat e dy poezive.

Mësuesi i nxit nxënësit në vëzhgim dhe pastaj në artikullimin me fjalë të vëzhgimit. Si në kapitullin tjetër, përpiqet që diskutimin ta lërë në planin e formës, për të mos shuar kuriozitetin e teksteve që do të bëhen më vonë. Gjatë pyetjeve ai krahas fjalëve: shkrimtar, titull, poet, tekst, poezi, vjershë, prozë, përrallë, fabul, tregim, etj., përdor edhe dramë, dialog, personazhe etj.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

SHQIPONJA

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale

Arritjet

- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë
- Dallon fjalët që rimojnë në vjersha
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar

Mësuesi shënon temën në tabelë për të tërhequr vëmendjen mbi objektin e tekstit. Ftohen nxënësit të tregojnë çfarë dinë për shqiponjën. Mësuesi që ka lexuar më parë disa gjëra më shumë për të, e shtyn klasën të tregojë veçantinë e saj si shpend, duke u përpjekur të gjejë tek nxënësit sa më shumë informacion, duke vlerësuar informacionet e veçanta dhe jo shumë të dëgjuara dhe duke i inkurajuar ata nxënës që i thonë.

Veçoritë për shqiponjën mund të shënohen në tabelë. Ftohen nxënësit të hetojnë, nëse mund të vendosim lidhje të veçorive të shqiponjës me ato të njerëzve, apo bashkësive njerëzore. Janë fakt, dëshirë apo fantazi ato lidhje?

Nga ana tjetër e tabelës shënohet flamuri dhe ftohen nxënësit të tregojnë se ç'është dhe pse përdoret. Mësuesi që ka menduar më parë, i tërheq nxënësit të jenë sa më pak retorikë dhe ta shohin atë si çështje nevojë për t'u dalluar, si çështje identiteti.

Mbasi mendon se është krijuar intuita e lidhjes së flamurit me shqiponjën, i fton nxënësit të dëgjojnë leximin e poezisë.

I pyet nëse u pëlqeu. I fton të kërkojnë në tekst gjërat që e bëjnë të bukur poezinë, duke i drejtuar tek vargu, rima, fjalët e veçanta, muzikaliteti.

E rilexon vjershën për ta shijuar, për bukuri. I fton edhe nxënësit ta rilexojnë edhe ata për qejfin e tyre.

I fton nxënësit të thonë vargjet me fjalët e tyre, duke u distancuar nga veta e autorit dhe duke i pyetur se pse janë zgjedhur pikërisht ato fjalë nga poeti (intuitivisht, por pa e thënë, nxënësit kuptojnë që ajo është gjuhë poetike që nënkupton më shumë asociacione, kurse gjuha jonë e zakonshme është më e drejtpërdrejtë. Këtë ata e ndiejnë kur përpiqen ta thonë me fjalët e veta poezinë, por “bien në kurthin” e fjalëve poetike)

Pastaj ftohen nxënësit të plotësojnë librin.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

DHJETORI

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar dhe lexuar e ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të dallojë pjesët e vjershës
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti dhe arsyet pse

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë dhe fjalët që rimojnë
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe arsyet pse
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar.

Mbasi mësuesi shkruan *DHJETORI*, i fton fëmijët të tregojnë se ç'është: është emri i një muaji/ është muaj i dimrit/është muaji i fundit i vitit/ është muaj festash...

I fton të tregojnë se çfarë kanë më shumë qejf në dhjetor. Çfarë u pëlqen më shumë?

I fton të ndjekin edhe se çfarë është e pëlqyeshme për autorin e poezisë.

Lexon poezinë.

Vazhdon diskutimin duke ftuar fëmijët të tregojnë me fjalët e veta se si e sheh autori i vjershës DHJETORIN.

Përpiqet të aktivizojë sa më shumë fëmijë dhe krahas përshkrimit të fjalëve të tyre, u kërkon edhe ndjesi ose eksperiencat e tyre personale.

I nxit të tregojnë edhe për strofat, vargjet, fjalët rimuese dhe i fton të përsërisin vargje duke shijuar ritmin.

I fton të plotësojnë librin.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Kristina Nystlinger

DY SHOQET

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar a lexuar dhe ta lidhë përmbajtjen e tekstit me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti dhe të tregojë arsytet pse.

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe çfarë i ka pëlqyer
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar

Mësuesi afron nxënësit tek horizonti i pritjes duke shkruar titullin DY SHOQET në tabelë dhe duke ftuar nxënësit të tregojnë se ç'do të thotë për ta fjala shok ose shoqe.

Shënohen fjalë kyçe që lidhen me miqësinë dhe mësuesi përqendrohet te komunikimi, si faktor i rëndësishëm i miqësisë.

Mund të krijohet edhe një skemë e formave të komunikimit: gjeste, shprehje e fytyrës, qëndrim, mënyrë të veshuri, mënyrë të shikuari ... fjalë etj. Mund të ftohen nxënësit të diskutojnë mbi to. Pyeten nxënësit, nëse do të mund të kishin shok apo shoqe të ngushtë dikë që nuk mund të flasë? Nxënësit ftohen në diskutim (por jo si qëllim në vetvete) dhe stimulohen të jenë të sqartë, por jo kategorialë. Në përgjigjet e tyre mund të pohojnë se do të kishin dëshirë, por mund të shohin vështirësi në faktin që nuk mund të komunikojnë gjithçka.

Mësuesi lexon pjesën.

I fton nxënësit të tregojnë dy personazhet kryesore: emrat e tyre. Të lexojnë për secilin nga një fjali. Të tregojë se çfarë kanë të përbashkët. Të tregojë se si e zgjidhën ata problemin e komunikimit.

I fton të tregojnë nëse i mbajtën mend disa forma komunikimi nga gjuha e gjesteve. I fton ta tregojnë përmbajtjen e këtij teksti me fjalët e veta.

E rilexon edhe një herë bukur. I fton ta lexojnë vetë edhe një herë dhe ta shijojnë. I fton të kujtojnë ndonjë detaj nga jeta e tyre që ngjan me ngjarjen e tregimit.

Ftohen ta diskutojnë në klasë.

Ftohen të punojnë me librat.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Adelina Mamaqi

QETËSI (Pjesë teatrale)

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të krahasojë llojet letrare sipas formës dhe përmbajtjes
- të dallojë pjesët që përbëjnë dramën

Arritjet

- Dallon pjesët e dramës: titull, fjalë të shkrimtarit, fjalë të personazheve
- Krahason krijimin duke pasur parasysh formën dhe përmbajtjen
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Thotë si e sheh sjelljen e personazheve
- Krahason sjelljen e personazheve të tekstit me sjelljen e vet

Një orë para mund të vihet në video-projektor të shihet një dramë për fëmijë.

Pasi shkruhet titulli, ftohen nxënësit të shikojnë pjesën dhe të tregojnë veçantitë e tekstit. Ftohen të diskutojnë se si është më mirë të lexohet ky tekst që ka më shumë se një personazh. Zgjidhet me klasën se si të lexohet.

Mbas kësaj, pjesën mund ta lexojnë nxënësit sipas roleve që zgjedhin dhe të folurës së kuptueshme dhe jo shumë të shpejtë. Ftohen të dëgjojnë me vëmendje dhe të ndjekin me lexim të tjerët.

Mbas kësaj mësuesi mund të fillojë diskutimin: Kush e ka shkruar pjesën? Për çfarë flet? Çfarë thotë Beni? Çfarë thotë Zana? Pse grinden ata? Kush ka të drejtë apo e drejta nuk është gjithnjë nga e njëjta anë?

Nxiten nxënësit të argumentojnë duke lexuar fjalë të personazheve. Ndërtohet një logjikë e konfliktit ku e drejta lëviz.

Ftohen nxënësit të shohin në libër.

Pas kësaj mund të ndërtohet një projekt për dramatizimin: Kush mund të bëhen aktorët (mund të zgjidhen dhe aktorët dublantë), kush do të bëhet skenograf, kush do të merret me realizimin e skenografisë, kush do të jetë kostumograf, regjisor, kush do të punojë si arkivist, kush do të jetë kritiku, kush biletashitësi, etj. Ky projekt mund të përfshijë edhe lëndë e orë të tjera, si: vizatim, punë dore etj..

Teatri mund të luhet dy ose tre herë (pa përjashtuar aktorët dublantë). Është e rëndësishme që të mos mbesë asnjë nxënës pa u aktivizuar dhe secili të ketë detyrën e vet.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

PËRRALLA E KLASËS

Është një traditë e bukur që nxënësit të krijojnë vetë një përrallë, prandaj e kemi ruajtur edhe në botimin e ri të librit.

Kjo ide mund të konceptohet si një projekt i shkurtër, objektivat e të cilit mund të vendosen nga mësuesi, duke u mbështetur në nevojat e klasës.

Objektivat e këtyre orëve mund të jenë pak dhe shumë të thjeshta, gjë që nënkupton që të përdoren në funksion të çlirimit dhe hapjes së nxënësit në aspekt të përgjithshëm psikologjik dhe komunikativ dhe të çlirimit të fantazisë nga stereotipet e saj.

Autori i njohur italian i Letërsisë për Fëmijë, Xhani Rodari (Giani Rodari), ka një libër që titullohet "Gramatika e fantazisë" (me nëntitull; Hyrje në artin e të krijuarit të historive), që mund t'i japë mësuesit ide interesante për t'i hapur rrugë fantazisë së fëmijës.

Tek fëmijët fantazia ka një fuqi të jashtëzakonshme çlirimi. Ajo lind spontanisht tek ata dhe mund të shprehet përmes fjalës, ashtu si edhe nëpërmjet pikturimit, vizatimit, ngjyrave, punëve të dorës etj..

Si teknika nga Rodari propozohen:

- T'i ftosh fëmijët në ndryshimin e një subjekti të njohur (përralle, fabule, tregimi etj.), si p.sh.: Na ishte ...*kësulëverdha*. Ajo po shkonte ...për të kërkuar *lëkura patatesh...*; ose për të ndryshuar sensin e personazheve dhe të ndodhive, si p.sh.: kësulëkuqja e keqe ... ujku i mirë; Hirushja bën sherre dhe ia humb durimin njerësis; Borëbardha takon 7 gjigandë dhe bën aventura duke u fshehur ... etj.

- T'u propozosh fëmijëve një hipotezë fantaziste, si p.sh.: Nëse qyteti do të fillonte të fluturonte, çfarë do ...

- T'i ftosh fëmijët të krijojnë personazhe krejt të veçanta, si p.sh.: një njeri qelqi, dylli, që shkrihet, ngjyroset, vizatohet, lahet, thyhet, deformohet etj .

Rodari thotë se është e rëndësishme që mësuesit t'i shtyjnë me mençuri fëmijët në çlirimin e fantazisë me fjalë, me qëllim që të gjejnë te fjala një mjet të pasur dhe tërheqës.

Megjithatë, ky ishte vetëm një propozim. Ju mund të keni ide më të mira.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

GËZIMET TONA

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë mendime dhe përjetime nga shokët e tij të klasës
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për ngjarje nga jeta reale
- të shoqërojë të folurën me fjalë që shprehin emocione dhe ndjesi

Arritjet

- Tregon autorët, titujt, llojet e teksteve të kapitullit
- Tregon për ngjarje reale të ngjashme me temat e titujve
- Shpreh mendimet e ndjenjat me fjalë e vizatim

Edhe në hyrjen e këtij kapitulli, objektivat janë sugjeruese. Ideja e zhvillimit të hyrjes së këtij kapitulli, krahas parapërgatitjes të tij, është edhe që të lidhë eksperiencën vetiake dhe familjare të nxënësit me atë të shkollës, gjë që e ndihmon nxënësin ta pranojë veten më mirë dhe të kërkojë më thellë te vetja.

Duke i mëshuar parimit receptiv, mësuesi mund të mendojë qendra stimuluese bisede, në të cilat ai pyet duke përdorur vetë disa fjalë çelës, me të cilat synon çlirimin emocional të nxënësit dhe rritjen e vetëdijes së tij për emocionet dhe ndjesitë.

Mësuesi mund të sjellë në klasë edhe ndonjë material ndihmës, krahas figurave të tekstit, për të provokuar kujtesën, si: figura të tjera, piktura, foto, ashtu si mund ta kërkojë këtë edhe nga nxënësit.

Pyetjet: *Kur jeni ndier të gëzuar? Çfarë ju ka gëzuar? Çfarë ju gëzon? Çfarë bëni kur gëzoheni? Çfarë ndjeni, kur jeni të gëzuar? Me kë keni qejfta ndani gëzimin? Po në tekst me çfarë mund të lidhet gëzimi i titullit të këtij kapitulli? Si mund ta gëzoni veten?* janë vetëm sugjeruese. E rëndësishme është që të aktivizohen të gjithë nxënësit. Mësuesi të mbajë shënim për gjëra të veçanta që mund t'i japin atij mundësi t'i përdorë më vonë për stimulimin e nxënësit. Biseda të tilla e ndihmojnë edhe mësuesin të kuptojë se çfarë e lumturon fëmijën dhe këtë ai mund ta përdorë për ta motivuar atë.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

GËZUAR DITËLINDJEN!

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale.

Arritjet

- Krahason sjelljen e personazhit të tekstit me sjelljen e vet
- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë dhe fjalët që rimojnë
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar.

Mësuesi shkruan titullin dhe i fton fëmijët të tregojnë ditëlindjet e tyre, si i festojnë ata, çfarë u duket e bukur në ato festa. Fëmijët lihen të flasin lirshëm.

Pastaj ftohen të dëgjojnë vjershën.

Listojnë gjërat e bukura në ditëlindjen e Elonës.

Ftohen të krahasojnë festën e saj me festën e tyre.

Mësuesi i nxit të rilexojnë vjershën, duke u thënë se ai është një krijim artistik dhe, si i tillë, ka qëllim të kënaqë. I nxit nxënësit të hetojnë pse i kënaq vjersha, duke i drejtuar edhe në hetimin e formës dhe të tingëllimit.

I fton të përsërisin vargje që i pëlqejnë dhe t'i recitojnë herën tjetër përmendsh. I stimulon për këtë, vazhdimisht, kur ka vjersha.

I drejton së fundi te teksti.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

TRI GËZIME

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të dallojë pjesët e tregimit

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar
- Dallon fillimin, zhvillimin dhe fundin e tregimit
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar

Mësuesi shkruan titullin në tabelë.

I nxit nxënësit të tregojnë kur janë ndier të gëzuar, së fundmi. Me çfarë e lidhin gëzimin ata. I nxit të mendojnë për ndonjë rast kur janë gëzuar, sepse kanë ndihmuar dikë. Njëkohësisht përpiqet t'i pyesë për gëzimin që ndihet kur gjendet diçka e pazakontë, si për shembull, perlat e detit. I pyet nëse e dinë se si formohen, a kanë parë ndonjë perlë në guaskë që nuk është bërë akoma margaritar?

Është e rëndësishme që në afrimin tek horizonti i pritjes, nxënësit të ndihen të ftuar për temën, por jo të konsumuar.

Pastaj mësuesi i fton të dëgjojnë leximin e pjesës dhe të kuptojnë se cilat janë tri gëzimet e djalit.

E lexon pjesën.

Meqë nuk është e lehtë, kërkon të lexohet edhe një herë me vëmendje nga nxënësit, duke u përpjekur të kuptojnë personazhet dhe veprimet e tyre.

Stimulon (me pyetje shumë graduale, konkrete dhe që nuk e lënë nxënësin të kapërcejë detaje të rëndësishme, që e ndihmojnë për të kuptuar) bisedën, duke pyetur: Si fillon tregimi? Pse rri çuni në kopsht? Çfarë merr ai? Ku shkon pastaj? Kë takon? Cili është gëzimi i tij i dytë? Kë sheh pastaj? Çfarë bën? Kush e sheh? Pse quhet "lumturia e tretë"?

I pyet nëse u sjell ndër mend ndonjë gjë margaritari i ngjitur në guaskë apo margaritari që është formuar dhe mund të dalë nga guaska? A mund të tregojnë këto detaje ndonjë gjë për çunin? A ngjason ai me djalin?

I fton të mendojnë dhe të thonë ç'do të thotë "lumturia e tretë e çunit është e të gjithëve"?

I fton nxënësit të ritregojnë përmbajtjen me sa më pak fjalë.

Mund t'i ftojë ta ndryshojnë përmbajtjen dhe të flasin mbi çfarë dhe pse e ndryshuan.

Lihen të plotësojnë në libër, në qetësinë e tyre.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

MOS E FSHIH FAJIN

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të dallojë pjesët e tregimit

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Shpreh ndjenjat me fjalë a vizatim për tekstin e lexuar
- Dallon fillimin, zhvillimin dhe fundin e tregimit.

Mësuesi tregon titullin e pjesës së leximit dhe i fton nxënësit të kujtojnë nëse kanë bërë ndonjëherë ndonjë gabim dhe janë munduar ta fshehin. Ndërkohë që i lë të mendohen, shkruan titullin në tabelë.

Nëse nuk ka përgjigje, atëherë përpiqet t'i nxisë të tregojnë, duke i inkurajuar. Pa e tepruar me nxitje dhe me shembuj, ftohen të ndjekin ngjarjen e tregimit.

Mësuesi lexon pjesën.

Fton nxënësit në diskutim (gjithnjë ftohen nxënësit të flasin me fjali shumë të shkurtra, sepse ato i ndihmojnë të përqëndrohen në strukturën e tekstit dhe lidhjen logjike të ngjarjeve, ashtu si i ndihmojnë të bëjnë më lehtë sintezën, përgjithësimin dhe abstragimin e fenomeneve): Si fillon tregimi? Cilat janë ngjarjet që ndodhin më pas? Si mbyllet tregimi?

Mbasi qartësohet struktura e tregimit me nxënësit, ftohen ta lexojnë vetë pjesën dhe të shënojnë ndonjë gjë (mund të jetë fjalë, fjali, paragraf) që i bën përshtypje.

Riftohen nxënësit të tregojnë përshtypjet dhe të reflektojnë më thellë. Diskutohen përshtypjet e tyre.

Ftohen të punojnë në libër.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

David Feil

EMA LEXON LIBRIN

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përmbajtjen e tekstit dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të krahasojë poezinë dhe tregimin si lloje letrare në formë.

Arritjet

- Krahason krijimin tregim me krijimin poezi, duke pasur parasysh formën
- Dallon personazhet kryesore dhe thotë si e sheh sjelljen e tyre
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Krahason sjelljen e personazhit kryesor të tekstit me sjelljen e vet

Mësuesi shkruan titullin në tabelë dhe përgatit horizontin e pritjes, duke e lidhur me argëtimin.

Ai mund të fillojë me fjalinë: Titulli është *EMA LEXON LIBRIN*, por kjo pjesë nuk lidhet thjesht me funksionin e librit për të të mësuar.

Pastaj mund t'i ftojë fëmijët të kujtojnë vargje poezish ku personazhet janë ndier të mërzitur, kanë bërë teka, s'mund të kënaqin veten, përplasen (Mësuesi mund të mendojë të sjellë vetë në klasë ndonjë poezi tjetër a prozë të shkurtër me tematikë të tillë).

I fton nxënësit të diskutojnë për përplasjet e fëmijëve, për të qarat e tyre. A janë karakteristikë e fëmijëve të vegjël këto gjëra, apo jo? I fton të mendojnë dhe të përgjigjen rreth pyetjes se pse të vegjlit përplasen dhe qajnë. Tendenca është që të shtyhen fëmijët nëpërmjet eksperiencave personale dhe arsytimit të kuptojnë se përplasjet dhe të qarat janë forma që nuk e zgjidhin problemin dhe si të tilla janë shpesh tregues të mosrritjes, kur fëmijët nuk dinë si mund ta zgjidhin problemin vetë. Pra fëmijët qajnë e përplasen, se duan zgjidhje, por nuk e shohin, ... nuk dinë si ta kërkojnë, ... e kërkojnë tek të tjerët, ... duan që të tjerët t'u vihen në shërbim ... e të tjera.

Ftohen nxënësit të dëgjojnë pjesën dhe të mendojnë se çfarë lidhjeje ka mes asaj që u bisedua dhe të Emës që lexon librin.

Mbas leximit, ftohen nxënësit në diskutim mbi pjesën: Cilat ishin personazhet? Çfarë bëjnë ato? Cili prej personazheve është i shqetësuar? Pse? Kush mundohet t'ia zgjidhë problemin? Kush ia zgjidh? Çfarë kishte Ema? Pse qante? Pse pushoi së qari? Çfarë bëri në fund ajo? Çfarë kuptuat ju nga kjo?

Nxënësit tërhiqen gradualisht në analizën e personazheve dhe botës së tyre, kuptimit të gjendjes dhe zgjidhjes së problemit).

Ftohen nxënësit të mendojnë nëse kanë provuar ndonjë situatë të ngjashme, qoftë edhe kur kanë qenë më të vegjël.

Pastaj ftohen të lexojnë edhe një herë pjesën vetë, para se të shohin detyrat e librit.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

EJANI DORË PËR DORE

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë mendime dhe përjetime nga shokët e tij të klasës
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për ngjarje nga jeta reale
- të shoqërojë të folurën me fjalë që shprehin emocione dhe ndjesi.

Arritjet

- Tregon autorët, titujt, llojet e teksteve të kapitullit.
- Bën krahasime formale mes poezive: mënyrës së vendosjes së vargjeve, strofave, gjatësisë së vargut, tingëllimit
- Shpreh mendimet e ndjenjat me fjalë.

Edhe në hyrjen e këtij kapitulli, objektivat janë sugjeruese. Si çdo hyrje kapitulli, edhe kjo synon parapërgatitjen e nxënësve me përmbajtjen e kapitullit (të parë nga jashtë), shikimin krahasues e sintetik të llojeve të leximeve që janë aty dhe lidhjen e eksperiencës vetiake dhe familjare të nxënësit me atë të shkollës.

Parimi receptiv në këto tema shprehet në fjalët kyçe që përgatit të përdorë mësuesi si bërthama diskutimi.

Krahas pyetjeve për titujt, autorët llojet, pyetjet krahasuese të poezive të ndryshme mund të jenë: Cila poezi i ka vargjet më të gjata? Si mund ta masim gjatësinë e vargut? (Mësuesi i lë nxënësit të zbulojnë vetë: ata le ta masin me gjatësinë fizike të vargut, pastaj me numrin e fjalëve. Mësuesi mund të japë shembull që argumenton se numri i fjalëve mund të gënjejë... e pastaj nxënësit mund të mendojnë edhe rrokjen... Nga mënyra se si e lexon vargun, i lë të kuptojë nxënësve rolin që ka rrokja edhe në muzikalitet). Si janë të shkruara vargjet, njëri pas tjetrit apo të grupuara në strofa? Strofat janë të njëjta apo të llojeve të ndryshme? A gjeni strofa apo monokolonë të ngjashme në poezitë e tjera të librit? A ndjeni një lloj muzikaliteti a bukurtingëllimi tek poezitë? Cila prej poezive të zhvilluara më parë ju pëlqen për muzikalitetin apo bukurtingëllimin që ka? Zgjidhni nga një secili dhe grupojuni në grupe sipas preferencave e pastaj përpikuni të tregoni pse ju pëlqen.

Veçantia e zgjedhjes mund të bëhet shkas i diskutimit të raportit të shoqërizimit dhe atij të qenurit vetiakë:

A janë grupet njësoj? (Mësuesi mund t'i shkruajë grupet shkurtimisht në tabelë). Çfarë do të thotë kjo? A mund të jetë i vetëm dikush në një grup? Si ndiheni kur jeni në një grup? Forca a vjen nga personi apo nga grupi? Do të mohoni veten, vetëm për të qenë në një grup më të madh? (Mësuesi vë theksin në daljen e idesë se madhësia e grupit nuk është ndryshim cilësor. Thjesht janë më shumë njerëz që kanë të njëjtën shije, kurse disa të tjerë janë më të veçantë. As shumësia e as veçantia nuk janë ndryshime cilësore. Janë nevojë që secili të jetë vetja.)

A mendoni njësoj, megjithëse jeni në një grup? A ju jep kënaqësi diskutimi me njëri-tjetrin dhe mendimet e ndryshme që ndërroni bashkë? Pse?

Mësuesi mund të ftojë nxënësit të reflektojnë për pëlqyeshmëritë e tyre edhe për gjëra të tjera. Ai mund të shkruajë në tabelë në një kënd tjetër lloje të ndryshme librash: Pastaj i pyet nxënësit se në cilin grup pëlqyesish do t'u pëlqente të hynin, tek pëlqyesit e:

- librave fantastikë
- librave me kuriozitete
- librave me përralla
- librave me tregime

Lihen nxënësit të japin mendime se çfarë u pëlqen. Ftohen të shikojnë grupet. Ato me siguri janë të ndryshme nga grupet e para.

Ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë mendojnë për këtë. Ftohen të përgjigjen edhe për shprehjen dorë për dore?

A mbahen dorë për dore tashti me ndonjë shok apo shoqe, apo në ndonjë lojë? A është e domosdoshme ta kenë shokun apo të afërmin të mbajtur për dore për të komunikuar për gjëra të rëndësishme apo të bukura? A mund të jetë mbajtja dorë për dore si diçka që është e mendueshme dhe jo e prekshme?

Nxënësit mund të ftohen të luajnë ndonjë lojë dorë për dore dhe pastaj edhe ndonjë lojë me fjalë (për shembull, kungulleshkash) ku është e rëndësishme që secili të ketë vendin e vet, se ndryshe nuk mund të luhet (çdokush duhet të ketë numrin e vet).

Mund të ftohen të shkruajnë si u ndien në këto orë diskutimi dhe çfarë i bëri të ndihen mirë.

Përsëri e rëndësishme është që të aktivizohen të gjithë nxënësit. Mësuesi të mbajë shënim për gjëra të veçanta që mund t'i japin atij mundësi t'i përdorë më vonë për stimulimin e nxënësit. Biseda të tilla e ndihmojnë edhe mësuesin të kuptojë pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës të cilat mund të përdoren në funksion të rritjes së tij shumëplanëshe.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

GURI I SKËNDERBEUT

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar e lexuar
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti dhe të tregojë arsyet pse

Arritjet

- Dallon personazhet kryesore dhe dytësore
- Tregon si e sheh sjelljen e personazheve
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe shpjegon arsyet pse

Mbasi mësuesi shkruan në tabelë titullin, meqenëse kemi të bëjmë me një tekst që ka personazh kryesor një personazh historik, horizonti i pritjes i nxënësit mund të krijohet edhe duke i pyetur nëse kanë dëgjuar për Skënderbeun dhe çfarë dinë për të.

Mësuesi mund t'i ftojë edhe të hipotezojnë mbi tregimin, pa e lexuar. (Si mund të jetë një tregim për shpatën e Skënderbeut, çfarë mund të thuhet për të ...)

Pastaj lexon pjesën.

Pyet nxënësit: Kush e ka shkruar pjesën (si distancim nga ajo që thuhet)? Për çfarë flet ajo? Cili është personazhi kryesor? Po personazhet e tjerë cilat janë? Çfarë bëri Skënderbeu? Çfarë thotë për gurin shkrimtari Naum Prifti? A mund të jetë e vërtetë kjo gjë? Çfarë ju duket interesante te kjo pjesë? Pse?

I fton nxënësit ta lexojnë me sytë dhe ritmin e tyre pjesën.

I fton të punojnë me detyrat e librit.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

MYSAFIRËT

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për përmbajtjen dhe ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të dallojë pjesët e vjershës

Arritjet

- Dallon pjesët e vjershës: titull, varg, strofë dhe fjalët që rimojnë
- Tregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Veçon çfarë i pëlqen dhe çfarë jo

Titulli i poezisë MYSAFIRËT që shkruhet në tabelë, mund të krijojë asociacione të ndryshme, sepse edhe mysafirët janë të ndryshëm.

Mund të ftohen nxënësit të tregojnë fjalë dhe shprehje të ndryshme që shoqërojnë përdorimin e fjalës mysafir: i huaj, i rrallë, i dashur, si p.sh.: ju nuk jeni të huaj, jeni të shtëpisë...

I fton nxënësit të dëgjojnë poezinë për të kuptuar se për çfarë mysafirësh e ka fjalën autori. Lexon poezinë.

Bën pyetje rreth tekstit në vargje, strofave, rimës: Si është i shkruar teksti? Si janë të organizuara vargjet? A kanë vargjet rimë?

Pastaj pyetje rreth përmbajtjes: Kush e ka shkruar poezinë? Kush është personazhi që flet? Kujt i drejtohet? Me çfarë fjalësh u drejtohet mysafirëve të vet të dashur (duke u kërkuar nxënësve që të shohin konkretisht në tekst)?/ Kë mund të dojë më fort personazhi ynë? Nga çfarë mund ta dalloni këtë gjë? Si mendoni? I fton nxënësit të krahasojnë mendimet dhe të argumentojnë zgjedhjen e vet.

Pastaj u propozon të punojnë me librin.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

SI U MËSUA FRANI TË LEXOJË

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar dhe lexuar, si dhe përmbajtjen e tekstit ta lidhë me ndonjë përjetim nga jeta reale
- të tregojë a i ka pëlqyer teksti dhe të tregojë arsyet pse

Arritjet

- Dallon ngjarjen, personazhet kryesore dhe dytësore
- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Thotë si e sheh sjelljen e personazheve
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar

Para se të shkruajë titullin, mësuesja mund të ndërtojë horizontin e pritjes duke ftuar nxënësit të diskutojnë mbi raste kur ata janë ndier të turpëruar, të zemëruar apo të fyer. Mësuesja mund t'i shënojë edhe këto fjalë kyçe në tabelë, pasi ato mund të ndihmojnë nxënësit të emërtojnë emocionet dhe ndjenjat.

Mësuesja mund të vazhdojë me rastin e tregimit për Franin, i cili ndoshta provoi pak nga të tria këto ndjesi.

I fton nxënësit të dëgjojnë tregimin.

E lexon. Pastaj pyet nëse u pëlqeu tregimi dhe pse.

I pyet se cilat janë personazhet kryesore dhe pse janë të tillë. A ka personazhe të tjera? Ç'rol luajnë ata në ngjarje, për se shërbejnë?

I fton nxënësit të tregojnë përmbajtjen, duke e ngjeshur nga njëri te tjetri.

I fton ta lexojnë bashkë edhe një herë, për të dalluar ndonjë detaj më shumë. E lexon artistikisht.

I fton të punojnë në libër.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

LIBRAT RRINË RADHË-RADHË

Rezultatet edukativo – arsimore

Gjatë procesit mësimor, nxënësi/ja do të mund:

- të dëgjojë, lexojë dhe kuptojë tekstin letrar
- të formulojë e të shprehë lirisht përshtypjet e veta për tekstin e dëgjuar dhe lexuar, si dhe ta lidhë përmbajtjen e tekstit me ndonjë përjetim nga jeta reale ,
- të tregojë a i ka pëlqyer a jo teksti dhe të tregojë arsyet pse.

Arritjet

- Ritregon me fjalët e veta përmbajtjen
- Tregon me fjalë a i ka pëlqyer teksti dhe shpjegon arsyet pse
- Tregon situata nga jeta reale, të ngjashme me ngjarjen e përshkruar
- Dallon fjalët që rimojnë në vjershë

Mësuesi shkruan titullin në tabelë për treguar se cila është pjesa që do të lexohet dhe u kërkon nxënësve që të tregojnë së ç'është ajo që ai po shkruan. Titulli? I kujt? I një vjershe? Nga çfarë përbëhet vjersha? Si janë të ndërtuara strofat? Cili është autori? ...

I fton nxënësit të ndiejnë edhe bukurtingëllimin e poezisë dhe i fton të mundohen ta kuptojnë si krijohet.

Lexon bukur vjershën.

I fton nxënësit të vërejnë ngjashmëritë tingullore mes fjalëve. Drejton bisedën tek ngjashmëritë e tingujve të fjalëve të fundit. I tregon se pse ato tingëllojnë më shumë, duke përsëritur vargje dhe duke i ftuar nxënësit të përsërisin vargjet që u pëlqejnë. Tregon se ka një emër për këtë dukuri që mund ta kenë përmendur dhe që quhet rimë.

I fton të gjejnë e ngjyrosin rimat. I shikon se çfarë kanë shënuar (ngjyrosur).

Shënon fjalë në tabelë dhe organizon lojën "Kush gjen më shumë fjalë që rimojnë" (Mund ta bëjë këtë lojë edhe me shkrim).

Më pas u kërkon nxënësve që të jenë të vëmendshëm ndaj përmbajtjes dhe i fton ta lexojnë poezinë secili më vete me ritmin personal.

Pas leximit bën pyetje të tilla, si: Kush e ka shkruar vjershën? Për çfarë flet ajo? Cilat janë personazhet? Ç'lidhje ka ai që ka shkruar vjershën me personazhet? Kush janë të dy? A ngjason personazhi i poezisë me ju? A keni qenë ndonjëherë në bibliotekë? A keni dëshirë të shkojmë bashkërisht dhe të shohim shumë lloje librash... etj.

I fton t'u përgjigjen pyetjeve të tekstit.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Në faqet e fundit të librit janë vendosur disa rubrika:

LIBRI IM, LIBRAT E MI

Në këtë rubrikë janë përgatitur disa fusha të zbrazëta, ku ftohen nxënësit të shkruajnë tituj tregimesh, vjershash e përrallash që kanë lexuar dhe pëlqyer.

Kjo gjë stimulon përballjen e nxënësit me eksperiencën e vet në të lexuar, përballjen me eksperiencën e leximit të shokëve dhe shoqëve dhe përjetimeve të tyre dhe gjithashtu ndihmon zhvillimin e mendimit, komunikimit dhe të individualitetit.

Duke pasur parasysh këto mundësi, mësuesi është i lirë t'i organizojë orët në funksion të objektivave kurrikulare apo edhe ekstrakurrikulare që mendon ai.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

LOJËRA ... PËRRALLA ... TREGIME ...

Pavarësisht se libri ka tregime e përralla në përmbajtjen e tij, janë shtuar si rubrikë më vete së bashku me lojërat, për të tërhequr vëmendjen e mësuesit në një këndvështrim më të lirë të tyre. Ato janë menduar të lidhen me eksperiencat personale të fëmijëve, me mundësinë për të organizuar integritime me pikturën, fotografinë, filmin, dramën etj.

Duke u konceptuar si të tilla, ata ndihmojnë aftësitë shoqërizuese të fëmijëve, zhvillojnë anën emocionale dhe vetëdijen për të, zhvillojnë aftësinë e vëzhgimit dhe të komunikimit etj.

Lojërat e ndryshme gjuhësore ose me gjeagjëza të tipeve të ndryshme i stimulojnë fëmijët të bëjnë analogji mes dukurive mbi përvojën e tyre të fituar, të bëjnë analiza e sinteza mendimi, të çlirohen nga stereotipet e mësimit dhe të mësojnë duke u argëtuar.

Që nxënësit të mos e shohin shkollën si vend të ngurtë, ku ata nuk mund të bëjnë asgjë nga ato që kanë qejf, janë lënë disa mundësi për t'u dhënë hapësirë fëmijëve të argëtohen, po në të njëjtën kohë, të mësojnë nëpërmjet disa objektivave që mësuesi i ka të fshehura, të padukshme dhe ndihmëse.

Përsëri u lihet në dorë mësuesve të organizojnë dhe harmonizojnë objektivat.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Leximet jashtë klase: XIXËLLONJA E VOGËL DHE PINOKU

Në Fletoren e punës përfshihen librat “Xixëllonja e vogël” e shkrimtarit Qamil Guranjaku dhe “Pinoku” e autorit Karlo Kolodi. Këto janë vepra për lexim jashtë klase, të parashikuara në Programin e ri mësimor për klasën e dytë të shkollës fillore nëntëvjeçare.

“Xixëllonja e vogël” është përmbledhje me vjersha me tematikë të ndryshme. Në Fletoren e punës janë përfshirë një tufë vjershash nga kapituj të ndryshëm të librit. Janë lënë edhe faqe vetëm me figura, në mënyrë që nxënësit të mund të shënojnë vargje të tjera nga vjersha të ndryshme dhe të bëjnë shënime që kanë qejf.

Fletorja e punës është menduar t’i ndihmojë nxënësit, që të dokumentojnë lidhjen me librat dhe të vëzhgojnë më mirë disa detaje. Kjo nuk do të thotë, se nxënësit nuk duhet të lexojnë libra të tjerë. Në fund të librit të leximeve jashtëklase ne kemi vënë edhe disa skeda leximi, që t’u shërbejnë nxënësve që duan të lexojnë edhe më.

Në Fletoren e punës ka edhe pyetje që mund të bëhen objekt komunikimi në klasë, edhe ilustrime, që nxënësit t’i ngjyrosin sipas dëshirës dhe fantazisë dhe t’i vendosin në stendën e klasës.

Edhe vepra e njohur e letërsisë për fëmijë “Pinoku” është konkretizuar me figura që kur Pinoku ishte kukull prej druri dhe deri sa u shndërrua në fëmijë të vërtetë.

Nxënësit, përmes ilustrimeve e pyetjeve për Pinokun, mund të japin mendime dhe mbresa për atë që lexojnë.

Fletorja e leximeve jashtëklase jo vetëm që i ndihmon nxënësit të mos ndihen vetëm në raportin me librin, por edhe i inkurajon të mos hezitojnë të shënojnë detaje, që të përjetojnë më mirë mendimet dhe emocionet që i shkakton leximi, për t’i ndarë më vonë këto edhe me nxënës të tjerë.

Mësues-i/ja duhet t’i mbështesë nxënësit në këtë drejtim, sepse komunikimi është nevojë e njeriut dhe komunikimi për gjëra të bukura, është kënaqësi. Nga ana tjetër, puna në këtë fletore mbështet predispozitat natyrore të proceseve mendore të nxënësit, ndihmon në krijimin e karakteristikave intelektuale dhe të personalitetit të tij.

Ajo përpiqet t’i ndihmojë nxënësit të kërkojë në thellësi të vetes të gjejë atë veçanti që e bën të ndihet unik.

